



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
SEKTORI I ASISTENCËS DHE SHËRBIMIT

Nr.18871/1 Prot.

Tiranë, më 31.8.2017

Lënda: Kthim përgjigje

TELEVIZIONIT KLAN
EMISIONIT INVESTIGATIV "STOP"
Rr."Aleksandër MOISIU", Nr.97

Tiranë

Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 14.08.2017, të protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr. 18871 Prot., datë 14.08.2017, bazuar në ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e Informimit", regjistruar në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me numër rendor 34, me lëndë: "Informacion", pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të Ligjit të sipërcituar, ju informojmë sa më poshtë vijon:

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore", i ndryshuar, në nenin 24 dhe 25, përcakton në mënyrë të qartë autoritetet dhe rrethanat, të cilave Administratat Tatimore mund dhe duhet t'iu ofrojë, pas kërkesës me shkrim, informacion tatimor për tatimpaguesit, të administruar prej saj dhe konkretisht citojmë: "*Informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga administrata tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:*

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhëniet të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhëniet të tij me administratën tatimore;
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;

dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;

e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.”

Për sa më sipër, duke mos qenë subjekt i nenit 24, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund t’ju ofrojmë informacion në lidhje me kërkesën e paraqitur nga ju.

ZV/ DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Xhavit Çurri

